



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.78, datë 28.06.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021 PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, LAGJA NR.17, RRUGA “LURA”, DURRËS TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin Nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit Nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetres së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisionit i Shqyrtimit të Ankesave, me propozim të Zëvendëskryetres së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.32, datë 26.03.2021 përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, lagja nr.17, rruga “Lura”, Durrës të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.32, datë 26.03.2021 të z. Gentian Luzi, si përfitues nga programi i procesit të rindërtimit të 4 banesave kolektive në lagjen nr.17, rruga “Lura”, Durrës, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Bashkia Durrës
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Nr. 3841/1 prot.

Durrës, më 23.06.2021

MIRATOI

ZËVENDËSKRYETAR

Emiriana Sako



RELACION

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM-sënr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” si dhe Vendimin nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetares së Bashkisë Durrës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mori në shqyrtim ankesën e, z. Gentian Kosta Luzi, banues në pallatin 1050, lagjja 17, Rruga “Lura” Durrës.

Z. Gentian Luzi me nr. ID H80223188S nuk ka rezultuar përfitues në programin e rindërtimit nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021.

Në vijim subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës nëpërmjet ankesës me nr. 3841 prot., datë 29.03.2021, duke kërkuar të përfshihet në listën e përfituesve. Ankesa u depozitua pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me datë 10.06.2021.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në shqyrtimin e ankesës vëren:

Subjekti Gentian Luzi ka aplikuar sipas Aplikimit nr. 120 prot., datë 27.02.2020, ku kërkesa është regjistruar me nr. 45437 në regjistrin elektronik. Në dosjen e aplikantit janë këto dokumenta:

Formular aplikimi për të përfituar nga Programi i Rindërtimit.

Certifikatë për vërtetim pronësie. nr. Pas., 5/256+1-18 ZK 8513 Vol: 13, Fq. 64, me sipërfaqe 77.50 m², aktualisht në pronësi të subjektit Gentian Luzi, lëshuar me datë 17.04.2020.

Harta Treguese e Regjistrimit.

Akt Konstatim i datës 05.12.2019.

Certifikatë familjare me përbërje prej 5 personash.

Fotokopje e Kartës së Identitetit.

Kontratë Dhurimi e datës 27.02.2020.

Prokurë nga Mariana Luzi dhe Kosta Luzi, ku Gentian Luzi autorizohet të nënshkruajë kontratën e dhurimit vetes së tij dhe të gjitha aktet që lidhen me këtë çështje për apartamentin me të dhëna, nr. Pas., 5/256+1-18 ZK 8513 Vol: 13, Fq. 64, me sipërfaqe 77.50 m², L: 17, Rruga "Lura", P. 1055, SH1, K6 Apt. 18 sipas Certifikatës së Pronësisë në emër të znj. Mariana Vasil Luzi e lëshuar më datë 20.09.2006 dhe kartelës bashkëlidhur.

Vërtetim nga Qendra Administrative nr.5. i datës 05.03.2021.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit sqarojmë se struktura përkatëse e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe Komisioni i Posaçëm për mos përfshirjen në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021, të ankimuesit i janë referuar kontratës së dhurimit që ankimuesi ka nënshkruar me prindërit e tij.

Pra shkurtimisht:

Banesa e prishur nga tërmeti, objekt i kësaj ankese, sipas referimeve më sipër i përkiste nëpërmjet certifikatës së pronësisë znj. Mariana Vasil Luzi, e ëma e ankimuesit, kjo certifikatë mban datën 20.09.2006. Në vijim pronarët e kësaj pronë, e ëma dhe babai i ankimuesit, sipas certifikatës së mësipërme për efekt të qëndrimit jashtë vendit kanë lëshuar një prokurë ku autorizojnë djalin e tyre të nënshkruajë në emër dhe për llogari të tij kontratë dhurimi për banesën në fjalë, duke shprehur vullnetin e tyre. Nëpërmjet kontratës së dhurimit është bërë kalimi i pronësisë dhe është bërë ndryshimi i pronësisë nëpërmjet regjistrimit në regjistrat hipotekorë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Durrës. Kontrata është nënshkruar para noteres znj. Diana Hoxha dhe mban datën 27.02.2020, datë që përkon me aplikimin që ankimuesi ka bërë pranë Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike (sipas edhe referimit të dokumentacionit që gjendet në dosje). Në vijim është lëshuar certifikata e re e pronësisë në emër të ankimuesit z. Gentian Luzi e cila mban datën 17.04.2020. Kjo është e provuar edhe nëpërmjet përgjigjes së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës e cila në renditjen nr. 129 - 133 klasifikon ankimuesin si person që është pronar për pronën objekt i këtij shqyrtimi por dhe që evidenton faktin që përbërja familjare e tij nuk ka prona të tjera në pronësi të regjistruara (shkresa e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës me nr. 26141 prot. datë 19.03.2021).

Në gjykimin tonë Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe Komisioni i Posaçëm kanë gabuar në mos përfshirjen e ankimuesit në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021. Kjo për dy arsye:

1. Certifikata e pronësisë në emër dhe pronësi të prindërve të ankimuesit është e vitit 2006 dhe kjo ishte thjeshtësisht e verifikueshme dhe

2. Njëri nga pronarët duhet të ishte shpallur si përfitues duke qenë në zotërim të plotë të pronës në sensin që minimalisht e ëma e ankimuesit duhet të ishte shpallur fituese duke qenë se aplikimet edhe pse nuk janë bërë fizikisht është mundësuar lidhja e pronësisë me certifikatën e përbërjes familjare në ditën e fatkeqësisë natyrore sipas VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Gjithsesi referuar VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” në pikën 5 përcaktohet se: “Aplikim paraqitet drejtëpërdrejtë në strukturën/ot përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose në zyrën e qëndrimit më një ndalesë të njësisë....”

Si edhe pika 8 që citon:

“Kërkesat e plotësuar me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacione që mundëson përpunimin e të dhënave si më poshtë vijon:

- a. Emrin, atësinë, mbiemrin
- b. Numrin e kërkesës
- c. Datën e dorëzimit, paraqitjes së aplikimit.
- d. Objektin e kërkesës,
- e. Adresën e kërkuarit
- f. Përbërjen familjare në momentin e kërkesës
- g. Dokumentacionin e pronësisë ose cdo akt për fitimin e pronësisë.



Sa më sipër në gjykimin tonë ankimuesi i plotëson këto kushte edhe pse normalisht këto kushte plotësoheshin edhe në fazën e parë kur është trajtuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe Komisioni i Posaçëm.

Gjendur përpara faktit që kemi një kalim pronësie të bërë ligjërisht përpara noterit publik dhe të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, përpara faktit kur kontrata e dhurimit që është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë sipas Kodit Civil është regjistruar rregullisht, përfshirja në listat e përfituesve duhet të ishte bërë nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe Komisioni i Posaçëm edhe pse regjistrimi nuk ishte finalizuar

nëpërmjet lëshimit të certifikatës se pronësisë sepse lëshimi i certifikatës së pronësisë thjesht një moment njohjeje dhe nuk mohon të drejtën e të qenit pronar.

Lidhur me këtë situatë jemi të mendimit që ankimuesi z. Gentian Luzi duhet të jetë në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021 duke u klasifikuar si përfitues referuar përsëri VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendim i cili klasifikon strukturën përfituese të banesës sipas pikës 20.1 dhe tabelës A sipas përbërjes familjare duke mbajtur në vëmendje edhe Aktin Normativ sipas së cilit neni 21 pika 2 citon:

përfitues të njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura.....struktura e njësisë së banimit që do ti kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur.

Pra në përfundim të këtij arsyetimi Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mendon të propozojë për miratim klasifikimin si përfitues i ankimuesit z. Gentian Luzi në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1.

Sa më sipër propozohet që kjo praktikë ti kalohet Këshillit Bashkiak Durrës për të mundësuar ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021 duke shtuar përfshirjen e z. Gentian Luzi në listën e përfituesve në masën 2+1.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE


ARBEN ISAKU



ARDJAN IKJAZAJ



ERMAL LAMA



BASHKIA DURRËS
Dt: 06/07/21 Nr. 7438/17
PROT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461/prot.
7.

Durrës, më 06.07.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 78 datë 28.06.2021 Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32 datë 26.03.2021 përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, lagja nr.17, rruga “Lura”, Durrës të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

